



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



QENDRA E SHËRBIMEVE
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA
CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES



Save the Children



DREJTËSIA RESTAURUESE DHE NDËRMJETËSIMI PËR TË MITURIT DHE TË RINJTË

MANUAL
PËR NDËRMJETËSIT DHE LEHTËSUESIT
E PROCESEVE RESTAURUESE

Tiranë, 2018

Ky manual u përgatit nga Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” në kuadër të projektit “Mbështetje për të miturit viktime dhe kundërvajtës përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit”, si pjesë e skemës së granteve të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Përmbajtja e manualit është përgjegjësi e vetme e Fondacionit “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Përgatiti: Dr. Brunilda Zenelaga

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA E PARË

I	Baza ligjore për shmangien, drejtësinë restauruese dhe ndërmjetësimin në legjislacionin shqiptar	5
a.	Procedura e shmangies, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit	5
b.	Procedura e ndërmjetësimit sipas Ligjit të Ndërmjetësimit	9
c.	Veprat penale që mund të zgjidhen me ndërmjetësim	11
d.	Kodi i Procedurës Penale	13

PJESA E DYTË

II	Modeli i balancuar i drejtësisë restauruese.....	14
a.	Roli i lehtësuesit	14
a.	Kush duhet të përfshihet në proces?.....	15
III	Si duhet të angazhohen palët në drejtësinë restauruese? ..	16
a.	Siguria	17
b.	Respekti	17
c.	Të udhëhequr nga nevojat dhe jo nga metoda.....	19
IV	Si duhet të përgatiten të miturit dhe të rinjtë për të marrë pjesë në proces?	20
a.	Përgatitja e të miturit përgjegjës për dëmin	20
b.	Përgatitja e të miturit të dëmtuar	21
c.	Përfshirja	22
V	Cilat janë proceset e ndryshme dhe kur duhet të përdoren ato?	23
a.	Ndërmjetësimi familjar	23
b.	Rrethi restaurues	25
c.	Ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës.....	26
ç.	Takimet restauruese në grup	27
d.	Rrjetet e mbështetjes dhe përgjegjshmërisë.....	29
VI	Si duhet të organizohen proceset?	32
VII	Burime informuese	34

SHKURTIME

DR	Drejtësia Restauruese
LNZM	Ligji për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve
KDPM	Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit
KK	Kodi Penal
KPP	Kodi i Procedurës Penale
NVK	Ndërmjetësimi Viktimë-Kundërvajtës
RRMP	Rrjetet e Mbështetjes dhe Përgjegjshmërisë

PJESA E PARË

I. BAZA LIGJORE PËR SHMANGIEN, DREJTËSINË RESTAURUESE DHE NDËRMJETËSIMIN NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

a. Procedura e shmangies, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit

Reformimi i sistemit të drejtësisë për të miturit në kontakt me ligjin, me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit (Kodi), ka sjellë dhe forcimin e sistemit të drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të të drejtave procedurale të këtyre të miturve. Duke marrë parasysh instrumentet ndërkombëtare, dhe në përputhje me politikat kombëtare për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve, Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit¹ ka parashikuar procedurën e shmangies nga ndjekja penale për të miturit. Në nenin 3, pika 23, jepet përcaktimi i kuptimit të termit ‘shmangie’.

Sipas KDPM-së, “Shmangie është masa alternative për mosfillimin, pezullimin ose pushimin e ndjekjes penale ndaj të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të këtij Kodi”.

Me parashikim e masës së shmangies, ligjvënësi ka pasur si qëllim zbatimin e një drejtësie sa më miqësore për fëmijët. Në procedurën e drejtësisë penale për të miturit iu është dhënë përparësi masave alternative të shmangies nga procedimi penal dhe zbatimit të masave të drejtësisë restauruese, duke i vlerësuar këto masa si mundësia e parë. Në vlerësimin që duhet të bëjnë organet kompetente, në aktet përkatëse të tyre, duhet të pasqyrohet mbajtja në vëmendje që masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal. Sa herë që të jetë e përshtatshme, e mundshme dhe e nevojshme, organet kompetente duhet të shmangin vënien në lëvizje të procedurës penale për të miturit në konflikt me ligjin, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e të miturit dhe mbrojtja e tij. Masat që përdoren ndaj të miturit, si alternativë për shmangien nga procedimi penal, duhet t’i shërbejnë qëllimit të mbrojtjes së të drejtave dhe garancive ligjore të të miturit.

Në Kod jepen përcaktimet se çfarë është një masë e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi:

¹ Ligj nr.37, datë 30.03.2017

Neni 3

12. “Masë e drejtësisë restauruese” është çdo masë, e cila lejon një të mitur në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigojë pasojat e një veprë penale, të kompensojë dëmet dhe/ose të pajtohet me viktimën/palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale, ku i mituri që ka kryer veprën penale dhe pala e dëmtuar marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për të zgjidhur pasojat e një veprë penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tretë të pavarur.

13. “Ndërmjetësim” është procesi i zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.

Neni 44 i Kodit parashikon mënyrën e informimit nga organet kompetente për masat e drejtësisë restauruese:

Neni 44

Masat e drejtësisë restauruese

1. Organi kompetent informon të miturin në konflikt me ligjin dhe viktimën, përfaqësuesin ligjor ose procedural dhe, sipas rastit, mbrojtësin e të miturit, për programet e drejtësisë restauruese.

2. Organi kompetent informon të miturin në konflikt me ligjin, përfaqësuesin ligjor ose procedural dhe, sipas rastit, mbrojtësin e të miturit, për mundësinë për të kërkuar kthimin dhe kompensimin e dëmit në gjykatë në qoftë se zbatimi i programit të drejtësisë restauruese nuk realizohet.

Ndërsa në nenin 45 parashikohet e drejta për kompensimin e dëmit:

Neni 45

E drejta për kompensimin e dëmit

1. Të miturit viktimë të veprës penale, si edhe përfaqësuesit të tij ligjor i komunikohet dhe i shpjegohet vendimi i gjykatës lidhur me veprën penale përkatëse, në mënyrë sa më të përshtatshme për moshën dhe nivelin e kuptueshmërisë.

2. Gjykata, nëse është rasti, e informon të miturin viktimë të veprës penale dhe përfaqësuesin e tij ligjor lidhur me të drejtën për kompensimin e dëmit të shkaktuar.

Në Kreun VIII të Kodit janë parashikuar rregulla të tilla si: kuptimi dhe qëllimi i masave alternative të shmangies; zbatimi i masave alternative të shmangies; organi kompetent për të zbatuar masën e shmangies nga ndjekja penale; kushtet për zbatimin e masës së shmangies; pëlqimi për masën e shmangies; garancitë e të miturit për marrjen e masës së shmangies; mundësia e prokurorit për kushtëzimin e vendimit; masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale; programet e drejtësisë restauruese dhe/ose ndërmjetësimi; procedura e ndërmjetësit; këshillimi për të miturin dhe familjen; paralajmërimi me gojë; paralajmërimi me shkrim; masat detyruese; vendosja nën kujdes e të miturit; përmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale; mospërmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale; procedura në rast mospërmbushjeje të masave alternative për shmangien nga ndjekja penale.

Neni 62 i Kodit përcakton dhe masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale. Konkretisht, masat që parashikon Kodi përfshijnë:

1. Programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimin;
2. Këshillimin për të miturin dhe familjen;
3. Paralajmërim me gojë;
4. Masat detyruese;
5. Vendosjen nën kujdes.

Pra, ndër masat alternative të mundshme për shmangien nga ndjekja penale janë dhe programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi. Nenet 63 dhe 64 përcaktojnë mënyrën e zbatimit të programeve të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësit. Organi procedues vendos për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese, në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësimin, me qëllim krijimin e mundësive për të miturin që të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë. Programi i drejtësisë restauruese mund të zbatohet nëse i mituri, mbrojtësi dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë dhe nëse çdo marrëveshje për korrigjimin e pasojave të veprës penale të kryer nga i mituri është e arsyeshme ose e përshtatshme.

Kur i mituri nuk ka prindër, ose ekziston një konflikt interesi midis prindërve dhe të miturit, pëlqimin për zbatimin e programeve të drejtësisë restauruese, mund ta japë një prej përfaqësuesve proceduralë, sipas parashikimeve të nenit 3, pika 17, të Kodit.

Në referimin e të miturit në programe të drejtësisë restauruese, mund të parashikohet që të miturit t'i kërkohet:

1. të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës së ardhur ndaj viktimës;
2. të kompensojë dëmin shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;
3. t'i kërkojë falje viktimës; dhe
4. të ndërmarrë veprime të pranueshme edhe nga viktima ose/dhe komuniteti.

Masat e drejtësisë restauruese mund të përfshijnë pjesëmarrjen në një program të shmangies dhe ndërmjetësit, të punës në interes publik dhe/ose çdo program tjetër që çon në rehabilitimin e pasojave të veprës penale të kryer nga një i mitur.

Ndërmjetësimi familjar dhe në grup është një tjetër masë alternative për shmang-

ien e ndjekjes penale, ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit. Në këtë proces, i akuzuari dhe familja e tij pritet të arrijnë një marrëveshje me viktimën, e cila përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë të akuzuarin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen.

Neni 64 i Kodit parashikon procedurën e ndërmjetësimit. Sipas Kodit “Ndërmjetësimi si procedurë jashtëgjyqësore zhvillohet nga ndërmjetësi sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjit në fuqi për ndërmjetësimin²”. Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimi i lirë për ndërmjetësim i shprehur si nga i mituri i akuzuar i veprës penale dhe nga pala e dëmtuar. Dhënia e pëlqimit duhet të shënohet në procesverbalin e organit procedues.

Ndërmjetësimi mund të zhvillohet vetëm me pjesëmarrjen personale të të miturit autor i veprës penale dhe palës së dëmtuar.

Në procesin e ndërmjetësimit, me pëlqimin e palëve, mund marrin pjesë gjithashtu përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurori dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij. Prokurori mund të marrë pjesë në procesin e ndërmjetësimit nëse ai e vlerëson.

Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rastit, mund të zbatohet edhe si masë shmangieje, por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale.

Prokurori gjatë hetimit dhe gjyqtari gjatë gjykimit, sipas rastit, mund të propozojnë ndërmjetësimin, nëse vlerësojnë se kjo alternativë është më e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri.

Në rast se propozimi i prokurorit/gjyqtarit për ndërmjetësim pranohet nga palët, atëherë prokurori/gjyqtari vendos pezullimin e procesit penal për një afat jo më shumë se 45 ditë. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit arrihet, prokurori/gjyqtari vendos pushimin e çështjes.

Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit nuk arrihet me kalimin e 45 ditëve, pezullimi bie dhe vazhdon hetimi/gjykimi i çështjes. Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit bëhen sipas legjislacionit në fuqi.

Në nenin 70 të Kodit parashikohet përmbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale dhe ndjekja e zbatimit të tyre. Nëse për të miturin që ka kryer një vepër penale, është dhënë një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale dhe kjo masë është përmbushur, ndaj tij nuk mund të ngrihet asnjë akuzë në lidhje me po këtë vepër penale. Nëse i mituri i përmbush detyrimet, sipas marrëveshjes së shmangies, prokurori vendos menjëherë pushimin e çështjes. I mituri që ka përmbushur një masë alternative për shmangien nga ndjekja penale nuk do të konsiderohet si i dënuar për një vepër penale dhe nuk do të trajtohet si person me të kaluar kriminale. Ndërsa për sa i përket mbikëqyrjes së përmbushjes së masës së shmangies

2 Ligji nr.10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar.

nga ndjekja penale, ajo kryhet nga Shërbimi i Provës, në bashkëpunim me shërbimin e ndërmjetësit.

b. Procedura e ndërmjetësit sipas Ligjit të Ndërmjetësit

Ligji nr.10385, datë 24.02.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar, përbën referencën kryesore për realizimin e shërbimit të ndërmjetësit. Ai përshkruan dispozitat bazë që duhet të ndiqen nga ndërmjetësi, si dhe bazën për procesin e plotë të ndërmjetësit, duke filluar me referimin e çështjes, caktimin e ndërmjetësit, e më pas me procedurën e ndërmjetësit, dhe raportimin në institucionin referues lidhur me rezultatin e çështjes së ndërmjetësuar.

Për sa i përket ndërmjetësit në çështjet penale, në nenin 2 përcaktohen dhe rastet të cilat mund të jenë objekt i ndërmjetësit:

2/3. Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë.

Gjithashtu në pikën 5 të nenit 2 përcaktohet se “në rastin e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur procedimi penal ka nisur, gjykata detyrimisht fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve të parashikuara në pikën 3 të nenit 2”.

Në nenin 17 të LNKM-së³ përshkruhet fillimi i procedurës së ndërmjetësit, duke e konsideruar një proces me disa elementë të rëndësishëm. Në mënyrë më specifike përcaktohen detyrat dhe roli i ndërmjetësit në fazën parandërmjetësuese, duke nisur nga informimi i palëve për qëllimet e seancave ndërmjetësuese dhe të parimeve mbi të cilat mbështetet ndërmjetësimi, të rolit të ndërmjetësit dhe të palëve në këtë proces, të efekteve të marrëveshjes së arritur ndërmjet palëve, të mbulimit të shpenzimeve si për ofrimin e shërbimit të ndërmjetësit dhe të kostove të tjera që lidhen me pjesëmarrjen e ekspertëve.

Në Komentarin e LNKM-së³, janë përshkruar në mënyrë të detajuar hapat që duhet të ndjekë ndërmjetësi për një proces të suksesshëm. Bazuar në praktikën ndërmjetësuese të vendeve perëndimore dhe në Shqipëri, suksesi ose mospuksesi i arritjes së zgjidhjes së një mosmarrëveshje varet në një masë të konsiderueshme nga profesionalizimi i treguar nga ndërmjetësi gjatë procesit parandërmjetësues.

Në procesin ndërmjetësues fillimisht duhet të arrihet një marrëveshje paraprake ndërmjet palëve. Siç është shprehur edhe në pikën 2 të nenit 17, palët dhe ndërmjetësi nënshkruajnë bashkërisht, me shkrim, marrëveshjen për realizimin e procesit të ndërmjetësit. Në këtë marrëveshje paraprake, përveç gjeneraliteteve të palëve dhe përshkrimit të objektit të mosmarrëveshjes, përshkruhet edhe pranimi në parim i ndërmjetësit si alternativë zgjidhjeje.

3 Komentari i ligjit “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, Nr. 10835, datë 24.02.2011, Botim i Fondacionit “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2012.

Në rastet kur palët në fillim të procesit të ndërmjetësimit nuk formalizojnë marrëveshje paraprake për mënyrën e realizimit të ndërmjetësimit, ndërmjetësi me iniciativë, siç është shprehur dhe në pikën 3 të nenit 17, e zhvillon ndërmjetësimin në mënyrën më të përshtatshme, duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes, kërkesat e palëve si dhe çdo element tjetër që ndihmon në zgjidhjen e shpejtë të mosmarrëveshjes. E shprehur ndryshe, ndërmjetësi, në konsensus me palët, përcakton vendin e organizimit të seancës ndërmjetësuese, kohën, mënyrën e pagës së shpenzimeve të shërbimit të ndërmjetësimit, si dhe merr në konsideratë kërkesa të veçanta të palëve që ndihmojnë në arritjen e marrëveshjes.

Në praktikën bashkëkohore të ndërmjetësimit është bërë normë që ndërmjetësi në seancën e parë të përbashkët të mbajë fjalën e hapjes, e cila shërben si themel mbi të cilën palët mund të fillojnë të gjejnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në mënyrë tipike, ndërmjetësi përpiket të flasë me një zë të qetë, jozyrtar dhe t'i bëjë palët të ndjehen mirë. E rëndësishme është që ndërmjetësi t'ua bëjë sa më të qartë palëve rolin e tij në proces.

Nuk ka ndonjë fjalë hyrëse të përsosur për të gjitha rastet. Më poshtë janë listuar çështjet më kryesore që duhen të merren parasysh gjatë fjalës së hapjes së ndërmjetësimit:

- U uron mirëseardhjen pjesëmarrësve.
- Prezanton veten (ndoshta pak fjalë për formimin si ndërmjetës dhe përvojën e tij në këtë fushë).
- Prezanton gjithë të tjerët, pjesëmarrës në ndërmjetësim, emrat dhe rolet në ndërmjetësim.
- Falënderon ata për mundësinë që i kanë dhënë që t'i ndihmojë në gjetjen e zgjidhjes përmes alternativës ndërmjetësuese.
- Komenton për lehtësitë e kësaj zgjidhje.
- Merr miratimin e palëve për të shpenzuar pak kohë për të përshkuar procesin e ndërmjetësimit.
- Përshkruan procesin dhe rolin e ndërmjetësimit.
- Konfirmon konsensusin për kohën që duhet shpenzuar në seancën ndërmjetësuese.
- Miraton arritjen e konsensusit ndërmjet palëve për shpenzimet e shërbimit të ndërmjetësimit të ofruar si dhe mënyrën dhe detyrimin e palëve.
- Sugjeron disa udhëzime për mbarëvajtjen e procesit (për dëgjimin me vëmendje, mos ndërprerje, shprehje qytetarie, respekt, etj).
- Shtron pyetje nëse pjesëmarrësit në ndërmjetësim kanë sugjerime të tjera.
- Konfirmon parimet që duhet të respektohen gjatë seancës ndërmjetësuese (konfidencialiteti, shmangia e paragjykitimit, vullnetarizmi).
- Konfirmon që në marrëveshjen paraprake ndërmjet palëve që pranojnë ndërmjetësimin janë përfshirë çështjet kryesore për të cilat është rënë dakord ndërmjet palëve në prani të ndërmjetësimit dhe pjesëmarrësve të tjerë, nëse ka.
- Ju bën të qartë palëve se në fund të seancës ndërmjetësuese, nëse arrihet një marrëveshje, ajo duhet të hartohet me shkrim dhe të nënshkruhet, si dhe i bën me dije se kjo marrëveshje, në respektim të ligjit, përbën titull ekzekutiv.
- I fton palët të tregojnë historinë e konfliktit sipas versionit të secilit.

Gjatë seancës, ndërmjetësi, siç është e shprehur në pikën 4 të nenit 17, duhet të

kujdeset për të siguruar trajtimin e njëjtë të palëve. Vendosja e kësaj balance ndërmjet palëve gjatë gjithë procesit ndërmjetësues është një element suksesi në ndërmjetësim. Është në thelbin e ndërmjetësimit si alternativë dhe metodë zgjidhjeje mosmarrëveshesh, vendosja e një ekuilibri në këtë proces, duke shprehur dhe demonstruar se palët në ndërmjetësim, pavarësisht nga diferencat e tyre, janë të barabarta. Konkretizimi më i mirë i këtij parimi është dhënia e barabartë për palët e kohës në seancën ndërmjetësuese, moslejimi i përdorimit të terminologjisë fyese dhe i simbolikës gjuhësore me dy kuptime, krijimi një mjedisi nxitës dhe komunikues për të gjitha palët, etj.

Roli i ndërmjetësit si lehtësues i seancës ndërmjetësuese përgjithësisht është disi pasiv, duke mundësuar daljen në plan të parë të rolit të palëve në procesin dialogues dhe negociues për arritjen e marrëveshjes. Gjithsesi ndërmjetësi, siç është e shprehur në pikën 5 të nenit 17⁴, mund dhe duhet të luajë rol proaktiv, kur konstaton se palët janë në rrugën e gjetjes së konsensusit ose të kompromisit, por kanë ngecur në mundësitë e zgjidhjes. Në këto raste, sipas ligjit nr. 26/2018, neni 27, pika 2, kur nuk vendoset paraprakisht ndryshe nga palët, në çdo fazë të zbatimit të procedurave të ndërmjetësimit, me kërkesë ose me miratim nga palët, ndërmjetësi mund të propozojë një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes. Ky propozim nuk është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga palët, përveç rastit kur ato bien dakord.

Në rast kur arrihet një marrëveshje, në bazë të LNKM-së, ajo hartohet në tri kopje, një për secilën palë dhe një kopje që depozitohet te subjekti ndërmjetës, i cili është i detyruar të administrojë çdo aktmarrëveshje dhe dokumentacion lidhur me to, sipas rregullave të përcaktuara nga Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve.

Kur çështja është referuar për ndërmjetësim nga gjykata ose institucionet të tjera përkatëse, ndërmjetësi, në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit, ose në afatin e përcaktuar prej tyre, i njofton ato për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes, duke dërguar edhe aktet përkatëse.

c. Veprat penale që mund të zgjidhen me ndërmjetësim

Cilat janë veprat penale për të cilat procedohet sipas neneve 59 dhe 284 të KPP?

Në bazë të nenit 59, të ndryshuar të Kodit të Procedurës Penale, i dëmtuari nga vepra penale ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, vetëm në rastin e disa veprave penale të parashikuara në Kodin Penal, si vijon: dëmtime të tjera me dashje (neni 90), plagosje e rëndë nga pakujdesia (neni 91), plagosje e lehtë nga pakujdesia (neni 92), dhunim i banesës (neni 112, paragrafi i parë), fyerje (neni 119), fyerje me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik (neni 119/b), shpifje (neni 120), ndërhyrje të padrejta në jetën private (neni 121), përhapje e sekreteve vetjake (neni 122), mosdhënia e mjeteve për jetesë (neni 125), marrja e padrejtë e fëmijës (neni 127), botimi i veprës së tjetrit me emrin e vet (neni 148), riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit (neni 149), si dhe shkelja e paprekshmërisë

4 I ndryshuar sipas Ligjit nr.26/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

së banesës (neni 254)⁵.

Kjo listë e veprave penale dhe rrjedhimisht edhe fusha e zbatimit të ndërmjetësim-it, ka ardhur duke u zgjeruar, pasi në vitin 2008 është shtuar rasti i nenit 119/b, pas shtesave të bëra në po të njëjtin vit në KP.

Për sa i përket rasteve të përcaktuara në nenin 284, të ndryshuar të KPP, në të cilat ankimi i të dëmtuarit nga vepra penale është kusht për nisjen e ndjekjes penale, llojet e veprave penale për të cilat mund të zbatohet edhe ndërmjetësimi janë si vijon: plagosja e lehtë me dashje (neni 89 KP), marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura (neni 102, paragrafi i parë), marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën (neni 105), marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari (neni 106), shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose për të zgjidhur martesë (neni 130), fyerja për shkak të detyrës (neni 239), shpifja për shkak të detyrës (neni 240), shpifja ndaj Presidentit të Republikës (neni 241), goditjet ndaj pjesëtarëve të familjes së personit që kryen një detyrë shtetërore (neni 243), detyrimi për të marrë pjesë ose jo në grevë (neni 264), përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike (neni 275), si dhe fyerja e gjyqtarit (neni 318)⁶.

Në dallim nga veprat penale të një rëndësie më të vogël, të treguara në nenin 59 të KPP, lista e veprave penale të treguara në nenin 284 ka ardhur duke u ngushtuar, pasi në vitin 1995 në të përfshihej edhe vrasja nga pakujdesia (neni 85 KP), e cila në vitin 2002 është hequr nga kjo dispozitë, duke e përjashtuar në këtë mënyrë edhe si një rast në të cilin mund të zbatohet instituti i ndërmjetësimit⁷.

A ka raste të tjera, në fushën penale, që mund të ndërmjetësohen?

Vetë ligji i ndërmjetësimit parashikon mundësinë e ndërmjetësimit kur ligji i veçantë e lejon atë, duke e lënë kështu këtë mundësi në varësi të rregullimeve të tjera ligjore, p.sh Urdhri nr.6325, datë 31.7.2009 “Për miratimin e Rregullores “Për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit”, të Ministrit të Drejtësisë si edhe VKM nr.302, datë 25.3.2009 për miratimin e Rregullores “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”.

Pra ligji na tërheq vëmendjen në tre raste të mundshme për t’u ndërmjetësuar dhe të detyrueshme që organi procedues të bëjë “ftesën për ndërmjetësim”:

- Çështjet me kërkesën e të dëmtuarit akuzues,
- Çështjet me ankimin e të dëmtuarit,
- Çështjet kur ligji i veçantë e lejon ndërmjetësimin.

5 Fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Komentari i Ligjit “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, Tiranë 2012, fq. 29.

6 Po aty, fq. 30.

7 Po aty.

d. Kodi i Procedurës Penale

Neni 338: Përpyekja për pajtim

1. Në rastin e veprave që ndiqen me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, gjykata thërret të dëmtuarin dhe atë kundër të cilit është bërë kërkesa për gjykim dhe u propozon zgjidhjen e çështjes me pajtim. Në qoftë se i dëmtuari e tërheq kërkesën dhe ai që akuzohet e pranon tërheqjen, gjykata vendos pushimin e çështjes. Në të kundërtën ajo cakton datën e seancës dhe u bën të njohur atyre se mund të ndihmohen nga mbrojtës.

Ligji për ndërmjetësimin u referohet këtyre neneve, kur përcakton procedurën e ndërmjetësimin në çështjet penale (neni 14):

14/1 Gjkata, në përputhje me nenet 333 dhe 338 të Kodit të Procedurës Penale, fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, parashikuar në nenin 2 pika 3 të këtij ligji, duke iu caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes.

14/2. Secila nga palët ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë rifillimin e gjykimit.

PJESA E DYTË

II. MODELI I BALANCUAR I DREJTËSISË RESTAURUESE

Modeli i balancuar i drejtësisë restauruese bazohet në besimin se secila palë në proces përfiton jo vetëm nga adresimi i nevojave dhe kërkesave të veta, por gjithashtu dhe nga adresimi i nevojave dhe dëshirave të palëve të tjera⁸. Kur njerëzit lëndohen, përjetimi i vuajtjeve shtohet nga mosadresimi i ndjenjave, nevojave dhe dëshirave të tyre. Kur të rinjtë lëndojnë të tjerë, reputacioni i tyre vihet në mëdyshje dhe ata konsiderohen si rrezik nga komuniteti i tyre. Në këtë kuptim, ajo që e lidh viktimën, autorin dhe komunitetin e tyre është dëmi i shkaktuar. Procesi i dhënies së një shpjegimi dhe llogarie për dëmin e shkaktuar dhe pasojat e tij, i shprehjes së keqardhjes dhe premtimi për të ndrequr dëmin dhe për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të shmangur veprime të tilla në të ardhmen, mund t'i shkëpusë të gjitha palët nga kjo lidhje. Procesi është një sfidë dhe duhet të drejtohet me përkushtim dhe mjeshtëri.

a. Roli i lehtësuesit

Qëllimi i lehtësuesit të një procesi të drejtësisë restauruese është që t'i angazhojë palët e përfshira në një ngjarje, që të plotësojnë nevojat e tyre dhe të bëjnë përpara me jetët e tyre.

Në Modelin European për Drejtësinë Restauruese për Fëmijët dhe të Rinjtë, autorët shprehen se nuk mund të thuhet se lehtësuesit e proceseve të drejtësisë restauruese janë neutralë ose të paanshëm, duke argumentuar se ata nuk janë neutralë ndaj dëmit që iu është shkaktuar të tjerëve, ndaj mbrojtjes së të drejtave, ndaj vlerave të respektimit të ndjenjave, nevojave dhe dëshirave të palëve dhe rëndësisë së marrëdhënieve të mira. Lehtësuesi i procesit është i përkushtuar që të mundësojë që çdo personi që merr pjesë në proces t'i plotësohen nevojat. Rrjedhimisht, ata janë në anën e gjithkujt. Disa autorë i referohen këtij roli si i karakterizuar nga shumanshmëria.

Në mënyrë që të mbahet një qëndrim moral ndaj veprimit që ka shkaktuar dëmin, secila palë merr të njëjtën rëndësi. Kjo kërkon një ndërgjegjësim të madh dhe mjeshtëri nga lehtësuesi. Aftësitë janë shumë të rëndësishme në lehtësimin e proceseve restauruese, por më e rëndësishme që të jesh 'restaurues' në marrëdhëniet me të gjitha palët. Kjo do të thotë të veprosh dhe të komunikosh mbi bazat e vlerave që janë kyçe në drejtësinë restauruese.

Që kjo të bëhet e mundur nevojitet që:

- Të gjitha palët të përjetojnë drejtësi përgjatë procesit;

8 Zinsstag, E., & Chapman, T. (2012). Conferencing in Northern Ireland: Implementing Restorative Justice at the Core of the Criminal Justice System. In E. Zinsstag, & I. Vanfraechem, Conferencing and Restorative Justice. Oxford: Oxford University Press.

- Të merren parasysh të drejtat e të gjitha palëve;
- Të mundësohet siguria e të gjitha palëve;
- Të mundësohet respektimi i të gjitha palëve;
- Të respektohet e vërteta e të gjitha palëve;
- T'u jepet rëndësi marrëdhënieve;
- T'i jepet rëndësi marrjes së përgjegjësisë nga palët;
- Të mundësohet gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja;
- Të mundësohet balancimi i nevojave dhe interesave të të gjitha palëve.

Thënë ndryshe, një lehtësues i cili vepron në bazë të këtyre vlerave, por i cili bën gabime, do të jetë më efektiv sesa një lehtësues që e ndjek procesin siç duhet, por nuk ia bashkëngjit këto vlera procesit.

b. Kush duhet të përfshihet në proces?


Drejtesia restauruese përqendrohet kryesisht në të kuptuarin dhe reagimin ndaj dëmit që u është shkaktuar njerëzve. Proceset restauruese janë të dizenuara për të “riparuar” marrëdhënien e dëmtuar ose për të bërë të funksionueshme një marrëdhënie të prishur. Këto procese nuk fokusohen tek ndëshkimi i fajtorit ose fajtorëve.

Kur shtrohet pyetja se kush duhet të ftohet të marrë pjesë në një proces restaurues, lehtësuesi i dialogut ose ndërmjetësi duhet të pyesë: kush është përfshirë në këtë situatë dhe kush është prekur nga dëmtimi i shkaktuar?

Shumë raste mund të trajtohen thjesht dhe shpejt përmes një “bisede restauruese” ose nëpërmjet një procesi ndërmjetësimi bazik ndërmjet dy palëve. Kur konflikti ose mosmarrëveshja e gjeneruar nga një veprim kundërvajtës nuk është shumë e përshkallëzuar, procesi i lehtësimit mund të mundësohet nga një mësues në një mjedis shkolle ose nga një oficer policie në rrugë. Por, disa situata kërkojnë më shumë përgatitje dhe një proces më të strukturuar dialogu, lehtësimit ose ndërmjetësimi, ku nuk përfshihen vetëm dy palët. Nëse dëmi vlerësohet si më kompleks dhe/ose më serioz, është e këshillueshme që të merret në konsideratë se si dëmi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, ka prekur edhe njerëz të tjerë, si dhe të vlerësohet nëse palët do të kërkojnë mbështetjen e familjes, kujdestarëve ose miqve për të hyrë në një proces restaurimi.

Disa veprime kanë një ndikim negativ të gjerë në një komunitet, për shembull në komunitetin e një shkolle, kështu që bëhet e nevojshme që në një proces restaurues të përfshihen edhe individë që përfaqësojnë nevojat dhe interesat e këtij komuniteti. Ky proces mund të marrë formën e një takimi restaurues në grup, ku mund të marrin pjesë:

- *Palët në mënyrë të drejtpërdrejtë*: viktimat dhe kundërvajtësi.
- *Komuniteti i mbështetjes së ngushtë*: familja, miqtë, etj.
- *Sistemet profesionale dhe institucionale*, ku përfshihen: gjykatat, shërbimet që përmbushin nevojat të veçanta, etj.
- *Komuniteti më i gjerë*: shkolla, lagja, organizata, etj.



Skema nr.1: Palët e përfshirë në proces

Disa lloje dëmsh mund të mos jenë shkaktuar nga një individ i vetëm ose mund të mos dëmtojnë vetëm një individ, por mund të përfshijnë një grup ose komunitet, e për rrjedhojë është përgjegjësi e atij grupi ose komuniteti për të riparuar dëmin. Një rast i tillë mund të lidhet me një problem të përgjithshëm të sjelljes në një klasë apo lagje.

Në raste të tilla, lehtësuesi mund të thërrasë një rreth restaurues (rrethi i paqes) duke përfshirë të gjithë ata që janë të prekur nga ngjarja ose veprimi kundërvajtës. Kur veprimet kundërvajtëse konsiderohen mjaft serioze dhe ndiqen penalisht në gjykata, kjo do të thotë se problemi nuk është vetëm një çështje private, por përbën një çështje që duhet adresuar sipas interesit publik. Kjo kërkon vëmendje në lidhje me seriozitetin e veprës penale dhe nevojën për ndërhyrje profesionale në bazë të një vlerësimi kompleks të nevojave individuale ose rrezikut për publikun. Në raste të tilla mund të ftohen avokatë dhe profesionistë të tillë si: punonjësit socialë, psikologët, punonjësit e shërbimit të provës, etj.

III. SI DUHET TË ANGAZHohen PALËT NË DREJTËSINË RESTAURUESE?

Angazhimi përbën një çështje kritike për suksesin e drejtësisë restauruese. Në disa raste, kur praktikohet drejtësia restauruese, palët nuk arrijnë të angazhohen në komunikim me njëra-tjetrën. Kjo është veçanërisht e vërtetë për angazhimin e palës që është dëmtuar. Zakonisht pala kundërvajtëse është më e prirur të marrë pjesë në një program të drejtësisë restauruese.

Pjesë e angazhimit në programet e drejtësisë restauruese janë edhe vetë lehtësuesit, ekspertët e dialogut dhe ndërmjetësit, sepse pa pjesëmarrjen e tyre nuk zhvillohet asnjë proces restaurues.

Procesi për angazhimin e të gjitha palëve, qoftë të kundërvajtësit, qoftë të viktimës, është i shumë i rëndësishëm. Megjithatë duhet mbajtur parasysh se, para së gjithash,

ata janë qenie njerëzore dhe përcaktimi i tyre si “viktimë” dhe “kundërvajtës” ndodh vetëm në lidhje me një veprim të caktuar që ka shkaktuar dëm. Gjatë procesit restaurues ata janë thjesht palë dhe trajtohen në mënyrë të barabartë.

a. Siguria

Lehtësuesi fillon me supozimin se është në interesin më të mirë të të miturve dhe të rinjve, që janë autorë ose viktimë, për të marrë pjesë në një proces restaurues. Kjo është e vërtetë në pjesën më të madhe të rasteve. Megjithatë, lehtësuesi duhet të pyesë me detaje nëse mund të ketë ndonjë arsye për të cilën procesi do të ishte i dëmshëm për secilin individ që do të angazhohet në këtë proces.

Direktiva Evropiane për Viktimat⁹ liston disa faktorë që duhet të merren në konsideratë, kur një rast i referohet programeve të drejtësisë restauruese. Këta faktorë janë:

- shkalla e traumës,
- shkelja e përsëritur e integritetit fizik, seksual ose psikologjik të viktimës,
- pabarazitë e pushtetit/ autoritetit dhe moshë,
- pjekuria ose kapaciteti intelektual i viktimës, që mund të kufizojë ose zvogëlojë aftësinë për të bërë një zgjedhje për të cilën të jetë mirinformuar.

Këta faktorë duhen marrë parasysh edhe në rastin e autorit. Është e rëndësishme të kuptohet se njerëzit i përjetojnë pasojat nga një kundërvajtje ose veprim i dëmshëm në mënyra të ndryshme. Kjo për shkak se njerëzit ndryshojnë në lidhje me nivelet e tyre të fleksibilitetit, nivelin e mbështetjes që u ofrohet dhe nga mënyra dhe masa se si veprimi i dëmshëm ka shkelur atë që ata vlerësojnë. Për këto arsye, i njëjti veprim mund të jetë burim irritimi për një person dhe burim traumash për një tjetër. Nëse identifikohet një pengesë ose mundësi për mospjesëmarrje të ndonjërës nga palët në proces, kjo nuk duhet domosdoshmërisht të shoqërohet me braktisjen e procesit. Rreziqet mund të kapërcehen me mbështetje, mund të eliminohen ose menaxhohen. Pengesat mund të adresohen duke e përshtatur procesin. Megjithatë, siguria e të gjitha palëve është kritike. Nëse lehtësuesi ka gjetur dëshmi se cenohet siguria e ndonjërës nga palët, këshillohet që procesi të mos vazhdojë.

b. Respekti

Nëse individët që kanë qenë të dëmtuar mendojnë se po ftohen të marrin pjesë në një proces restaurues për të dënuar kundërvajtësin ose palën që ka shkaktuar dëmin, atëherë ata nuk kanë gjasa të bien dakord. Atyre duhet t'u ofrohet mundësia që të adresojnë nevojat e tyre. I gjithë procesi duhet të lehtësohet duke nxitur respekt të thellë kundrejt përvojës së secilës palë, kundrejt ndjenjave, nevojave dhe qëndrimeve

9 Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012, establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32012L0029>, cituar më 03.04.2018


të tyre. Lehtësuesi duhet të japë një model pozitiv për palët, duke treguar respektin e tij për pikat e forta që secili person demonstroi nëpërmjet angazhimit në procesin e drejtësisë restauruese; të tilla si: guximi, inteligjenca dhe aftësia për të komunikuar.

Duke marrë këtë model respekti nga lehtësuesi, palët kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të nxiten ta trajtojnë gjithashtu njëri-tjetrin me respekt. Pala përgjegjëse për dëmin e shkaktuar zakonisht e vlerëson lehtësuesin që nuk e bën atë të ndjehet një 'person i keq'.


Një rëndësi e veçantë në proceset restauruese i jepet tregimit (rrëfimit) të historisë nga vetë palët. Duke i ftuar njerëzit të tregojnë historinë e tyre, u krijon në këtë mënyrë mundësinë të fillojnë të tregojnë dhe të përfundojnë historinë duke zgjedhur të nxjerrin në pah atë që ata e konsiderojnë më të rëndësishme dhe të mos tregojnë atë që nuk duan të thonë ose që e vlerësojnë si të parëndësishme. Dëgjimi me kujdes, pa i imponuar palës një strukturë pyetjeje të përgatitura nga lehtësuesi, është një akt respekti ndaj palës. Ky dëgjim si dhe demonstrimi i përpyekjes për të kuptuar historinë e një personi tjetër nëpërmjet pyetjeve, reflektimit dhe përmbledhjes, krijon një marrëdhënie inkurajuese për pjesëmarrjen në proceset restauruese. Në bazë të asaj që është dëgjuar, lehtësuesi mund t'i mundësojë palëve thellimin në tregimet e tyre, nëpërmjet pyetjeve të hapura, pohimeve, dëgjimit reflektues dhe përmbledhjes. Pra duhet mbajtur parasysh se pyetjet e lehtësuesit janë në përgjigje të asaj që ka thënë pala dhe nuk kanë për qëllim të udhëheqin bisedën. Ky proces u mundëson palëve të shqyrtojnë kompleksitetin e përvojës së tyre që lidhet me dëmin dhe, ndoshta, të mendojnë në mënyrë kritike rreth disa ideve të përgjithshme që ata kanë rreth problemit dhe zgjidhjes së tij. Lehtësuesi zakonisht paraqet kuriozitet për atë që ka ndodhur në detaje. Kjo tregon se ai ose ajo po e merr shumë seriozisht të kuptuarin e situatës.

Këto aftësi përshkruhen nga autorët Miller dhe Rollnick (1991) në librin "Intervistimi motivues: Përgatitja e njerëzve për ndryshim". Në procesin e restaurimit tregimi i individit shpreh të kuptuarit e ngjarjes për atë person. Çelësi për kuptimin e vërtetë të ngjarjes dëmtuese për një palë shpesh gjendet në përmbajtjen emocionale të tregimit të saj. Lehtësuesi kontrollon paraprakisht kuptimin e emocionit të palës dhe më pas fton individin të marrë në konsideratë domethënien e nevojave të paplotësuara që shkaktojnë këtë emocion.

Ka katër emocione që gjenden të përsëritura në shumicën e tregimeve të dëmeve dhe efekteve të tyre: (1) zemërimi, (2) frika, (3) ankthi dhe (4) turpi. Nëse këto emocione nuk merren seriozisht dhe nuk shqyrtohen, ata ndikojnë negativisht tek individit. Zemërimi ose frika që përjeton pala viktimë, mund ta çojnë atë drejt një kërkese për ndëshkim ose mbrojtje. Ankthi ose turpi që përjeton pala që ka kryer kundërvajtjen mund ta çojnë atë drejt një strategjie për të fituar simpati dhe për të shpëtuar nga pasojat e veprimeve të tij/saj ose drejt një strategjie tjetër për të shmangur përgjegjësinë dhe për të fajësuar të tjerët për dëmin. Asnjë nga këto strategji nuk ka të ngjarë të riparojë ndikimin e dëmit tek secila palë. Diskutimi përbën një mjet njohës dhe nxit të kuptuarit e njerëzve për një ngjarje apo çështje dhe për përgjigjen e tyre ndaj kësaj ngjarjeje. Njerëzit e zhvillojnë diskutimin me besim dhe përkushtim ndaj 'të vërtetës' së tyre. Diskutimi i tyre shpesh nuk rrjedh nga reflektimi personal në lidhje me një ngjarje të vërtetë që ata kanë përjetuar, por nga një sërë idesh që ata kanë marrë nga rrëfimet publike të ngjarjeve të ngjashme.



Skema 2: Përgjigja popullore ndaj dëmit



Skema 3: Përgjigja restauruese ndaj dëmit

Duke respektuar emocionet dhe duke iu shmangur përfshirjes në një debat rreth çështjes, lehtësuesi shqyrton nevojat e palëve. Kjo bëhet përmes një shqyrtimi të hol-lësishëm të kontekstit në të cilin ndodhi dëmi për secilën palë. Zemërimi është një reagim legjitim emocional ndaj një padrejtësie dhe shpesh nënkupton nevojën për drejtësi. Në mënyrë të ngjashme, frika tregon një nevojë për të qenë i sigurt. Ankthi është shpesh një përgjigje për të ndërë se ke humbur kontrollin e jetës tënde. Turpi përfaqëson në shumë raste nevojën për të rifituar respektin.

Siguria, kontrolli, autonomia dhe respekti janë të gjitha nevojat që mund të adresohen më efektivisht përmes një procesi restaurues sesa nëpërmjet proceseve më formale dhe më pak të personalizuar. Duke identifikuar këto nevojat, pala mund të inkurajohet të marrë në konsideratë se, nëse takohet me palën tjetër, cilat pyetje do të dëshironin t'i bëheshin dhe cilat kërkesa do të dëshironin t'i merreshin parasysh. Kjo mund të krijojë idenë se historia shqetësuese, e cila dominon jetën e tyre, mund të përfundojë vetëm me takimin me palën tjetër. Përmes këtij procesi angazhues, secila palë kalon nga të qenit pasiv drejt një pjesëmarrjeje aktive në një proces drejtësie. Është e rëndësishme pra, që lehtësuesit të mos e “shesin” procesin e restaurimit tek palët ose t'i bindin ata të marrin pjesë. Ata nuk duhet madje as të përpiqen të motivojnë palët. Ajo që bën lehtësuesi është identifikimi i motivimit të secilës palë dhe nxjerrja në pah e tij. Përveç një hyrjeje të shkurtër në fillim të takimit, moderatori ose lehtësuesi nuk duhet të përshkruajë në detaje procesin. Fillimisht lehtësuesi duhet të identifikojë nevojat dhe kërkesat e palës e pastaj të përshkruajë se si një proces restaurues mund të jetë i rëndësishëm për atë individ, duke i mundësuar atij të parashikojë pjesëmarrjen në një takim të tillë.

c. Të udhëhequr nga nevojat dhe jo nga metoda

Lehtësuesit nuk duhet të supozojnë se pala e dëmtuar është entuziaste për drejtësinë restauruese. Prandaj, është më e rëndësishme të dëgjohet me respekt dhe të mblidhet informacion nga palët për nevojën e tyre që lidhet me të dëmin, sesa të mblidhen informata të tjera dhe për të nxitur një zgjidhje përpara se të identifikohet dhe të sqarohet problemi. Pasi të tregohet plotësisht historia e dëmit dhe pasi palët dhe lehtësuesi të kuptojnë ndikimin e dëmit dhe të emocioneve, nevojave dhe kërkesave që dalin nga dëmi i shkaktuar, lehtësuesi duhet të shpjegojë procesin, duke i vendosur palët në mënyrë aktive në këtë proces; p.sh. duke iu drejtuar palës në mënyrë të tillë “Në këtë fazë ju mund të pyesni X-in pse ai ju ka sulmuar”. Pasi procesi të

jetë kuptuar, lehtësuesi duhet të shqyrtojë me palët çdo shqetësim ose frikë që ato mund të kenë në lidhje me pjesëmarrjen. Secila nga këto ndjenja duhet të shprehet në mënyrë specifike dhe konkrete, pasi në këtë mënyrë lehtësuesi mund të krijojë një përgjigje, e cila do të kënaqë individin.

Përveç përshkrimit të procesit, lehtësuesi duhet të shpjegojë rregullat bazë të cilat janë menduar për ta bërë procesin të sigurt, konfidencial, të drejtë dhe të respektueshëm. Lehtësuesi duhet të sigurojë secilën palë se është përgjegjësi e lehtësuesit për të ndërhyrë në qoftë se ndonjë nga rregullat shkelet. Është e rëndësishme që të caktohet kohë e mjaftueshme për angazhim. Hulumtimet kanë nxjerrë në pah se letrat që u drejtohen palëve përgjatë proceseve restauruese zakonisht janë joefektive. Thirrjet telefonike rrallëherë e lejojnë lehtësuesin të krijojë raportin, besimin dhe autoritetin, i cili është aq i nevojshëm për secilën palë. Në mënyrë ideale, kontakti duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe duhet të bëhet në vendin e zgjedhur nga palët, siç është për shembull shtëpia e tyre.

Këshillë e rëndësishme për praktikuesit e DR-së

Qasja ndaj pjesëmarrjes në një proces restaurues nuk bazohet në pyetjen e palëve: “A jeni të gatshëm dhe të aftë për të marrë pjesë në një proces restaurues?”

Çështja kyçe është: “Çfarë jeni të gatshëm dhe në gjendje të bëni për riparimin e dëmit dhe për çfarë mbështetje keni nevojë?”

IV. SI DUHET TË PËRGATITEN TË MITURIT DHE TË RINJTË PËR TË MARRË PJESË NË PROCES?

E drejta e të miturve dhe të rinjve për t'u dëgjuar në vendimet që ndikojnë në mirëqenien e tyre është thelbi i procesit të restaurimit. Kjo e drejtë duhet të mbështetet në mënyrë proaktive. Të miturit dhe të rinjtë po ftohen të takojnë një grup njerëzish, përfshirë ata me të cilët ata mund të jenë në konflikt. Shumica e këtyre njerëzve do të jenë të rritur. Njerëzit kanë ardhur në takim për të folur për diçka që mund të ketë shkaktuar zemërim, frikë, ankth dhe turp. Kjo do të jetë një ngjarje shumë sfiduese për shumicën e të miturve. Ata kanë nevojë për mbështetje dhe përgatitje për të dëgjuar zërin e tyre.

a. Përgatitja e të miturit përgjegjës për dëmin

Kur, i mituri ose i riu që është përgjegjës për dëmin, përgatet për të marrë pjesë në proces, është e rëndësishme që lehtësuesi të punojë nga një pozitë respekti.

- Të miturit dhe të rinjtë (adoleshentët) duhet të bëhen të vetëdijshëm se qëllimi parësor i takimit është të riparohet dëmi ose humbja që ka shkaktuar vepra e dëmshme.
- Duhet mundësuar që të miturit dhe të rinjtë të përqendrojnë vëmendjen në

radhë të parë në veprimin e dëmshëm dhe të marrin në konsideratë se çfarë përgjegjësie janë të gatshëm dhe të aftë të marrin në lidhje me të.

- I mituri dhe i riu mund të ketë nevojë për mbështetje në përgatitjen e dhënies së llogarisë ose rrëfimin e asaj që ka ndodhur. Lehtësuesi duhet të pyesë se kujt duan t'i drejtohen për një mbështetje të tillë? Çfarë lloj mbështetjeje do të kërkonin? Përkrahësi i tyre (nëna, babai etj.) nuk mund të flasë për ta, por mund të jetë në gjendje t'i ndihmojë ata të flasin për veten e tyre.
- Lehtësuesi duhet të përqendrohet në atë se çfarë mund të thotë i mituri, i riu/e reja, por nuk sugjeron se çfarë duhet thënë.
- Është e rëndësishme të mbahet mend se nuk është roli i lehtësuesit të detyrojë të miturit/ të rinjtë për të marrë përgjegjësi. Aftësia është t'u mundësohet atyre të "detyrojnë" veten duke pranuar se çfarë ka ndodhur.
- Lehtësuesi mund t'u kërkojë të miturve/të rinjve të imagjinojnë se si mund të reagojnë palët e tjera ndaj asaj që ai/ajo planifikon të thotë. Kjo mund të çojë në një diskutim se si i mituri/i riu do të përgjigjet nëse përballlet me mosbesimin, zemërimin, ose lotët e palës tjetër, etj. Nëse i mituri/ i riu nuk është i sigurt nëse ai ose ajo mund ta përballojë këtë reagim, lehtësuesi duhet ta pyesë se për çfarë mbështetjeje ka nevojë ai/ajo për ta përballuar këtë situatë.
- Lehtësuesi inkurajon të miturin/të riun të mos shprehë keqardhje të vërtetë, derisa ai ose ajo të dëgjojë me shumë kujdes historinë e palës tjetër.
- I mituri/ i riu duhet të dijë që, sapo pala tjetër të bindet se nevojat e tij ose të saj janë adresuar, mund të bisedojë rreth asaj se çfarë duhet bërë për të shmangur veprimet e mëtejshme të dëmshme. Kjo do të krijojë mundësinë që i mituri/ i riu të flasë për ndonjë gjë që e shqetëson atë. Kjo nuk duhet të bëhet për t'i bërë palët të ndjejnë simpati për njeri-tjetrin, por duhet të përdoret si një mjet për të identifikuar se si mund të mbështetet i mituri/i riu të ndërmarrë hapa për të zgjidhur problemet.
- I mituri/ i riu duhet të kuptojë se, për sa kohë që njerëzit shprehin mosmiratim të asaj që ai ose ajo ka bërë, ata nuk do ta respektojnë atë si person. Në fakt, procesi ofron një mundësi për të fituar respekt duke u përballur me atë që ai ose ajo ka bërë, duke e ndrequr atë dhe duke ndërmarrë veprime për të shmangur dëmtime të mëtejshme. Duke bërë këtë, i mituri/i riu mund ta zhvendosë të gjithë incidentin në të kaluarën dhe të lëvizë nga ai.

b. Përgatitja e të miturit të dëmtuar

Duke e përgatitur të miturin/të riun, i cili është dëmtuar, lehtësuesi duhet të krijojë raporte respekti me të, por pa qenë tepër mbrojtës kundrejt tij/saj, domethënë të mos e mbrojtë më shumë seç duhet.

- I mituri/i riu duhet të jetë i vetëdijshëm se qëllimi parësor i takimit është riparimi i dëmit të shkaktuar nga kundërvajtja apo vepra penale.
- Ai/ajo ka një rol të rëndësishëm në tregimin e asaj që ka ndodhur, duke përshkruar në mënyrë sa më specifike efektet e dëmit të shkaktuar.
- Është e rëndësishme që i mituri/i riu të kuptojë: A është i qartë ai/ajo për efektet dhe a është i përgatitur t'ia transmetojë ato palës tjetër? A ka

nevojë për më shumë mbështetje për ta bërë këtë? Nëse po, kush duhet ta japë këtë mbështetje dhe çfarë lloj mbështetjeje duhet dhënë? Ç' pyetje dhe kërkesa ka për palën tjetër? Çfarë do të bëjë ai/a jo nëse personi tjetër nuk përgjigjet në një mënyrë të kënaqshme?

- Lehtësuesi duhet të fokusohet në faktin se si ai/a jo mund ta tregojë ngjarjen dhe efektin që ka pasur, por jo t'i sugjerojë se çfarë duhet të thotë.

c. Përfshirja

Në Irlandën e Veriut, procesi është përshtatur për fëmijët në spektrin autistik. Procesi mund të ndryshohet për të qenë më gjithëpërfshirës për fëmijët që e kanë të vështirë të tregojnë me fjalë atë që ka ndodhur ose si ndjehen.

Është përgjegjësi e lehtësuesit për ta bërë procesin të përshtatet me palët. Kjo vlen edhe për fëmijët e kulturave dhe feve të ndryshme dhe fëmijët që nuk flasin rrjedhshëm gjuhën e vendit ku jetojnë. Praktikuesit/lehtësuesit duhet të inkurajohen të jenë krijuar në mënyrën se si u mundësojnë fëmijëve të komunikojnë. Ata mund të zhvillojnë dhe përdorin mjete vizuale dhe të tjera për të komunikuar me fëmijët në procesin e drejtësisë restauruese. Hulumtimet kanë treguar se nga 65% deri në 91% e fëmijëve në sistemin e Drejtësisë për të Miturit në Britaninë e Madhe kanë nevojë për bashkëbisedim dhe komunikim. Nëse praktikuesit/lehtësuesit nuk i përshtasin metodat e tyre të komunikimit me këta fëmijë, pikëpamjet e këtyre fëmijëve nuk do të dëgjohen. Më keq akoma, paaftësia e tyre për të folur në një takim bashkëbisedues do të interpretohet si mungesë pendimi. Praktikuesit/lehtësuesit duhet të përkthejnë zhargonin e restaurimit në një gjuhë miqësore me fëmijët. Takimi restaurues në grup do të thotë 'një mundësi për të takuar njerëzit që u lënduan dhe për të ndrequr gjërat dhe për të mos i përsëritur më '.

Përgatitje do të thotë: "Ju duhet të dini se çfarë doni të thoni, kur dhe kujt t'ia thoni para se të hyni në dhomën e bashkëbisedimit."

Këndvështrim do të thotë "Historia e secilit do të jetë e ndryshme."

Mospërbushje do të thotë 'Nëse e thyen premtimin, do të duhet të shpjegosh pse dhe nëse nuk ke një arsye të mirë, mund të gjendesh në më shumë vështirësi'.

Përdorimi i mjeteve vizuale: Këto elementë mund të mbahen parasysh për të nxjerrur nga lehtësuesi pjesëmarrjen e të gjithë të miturve/të rinjve në proceset restauruese, si figura të ndryshme për të identifikuar ndjenjat, etj.

V. CILAT JANË PROCESET E NDRYSHME DHE KUR DUHET TË PËRDOREN ATO?

Drejtësia restauruese mund të zbatohet nëpërmjet proceseve (metodave) të ndryshme, por më të përdorurat janë:

a. Ndërmjetësimi familjar

Ndërmjetësimi familjar përbën një metodë restauruese, përmes të cilës anëtarët e familjes dhe/ose kujdestarët lehtësohen për të diskutuar çështje të vështira dhe dalin me një plan për t'i adresuar ato. Kjo metodë ka rezultuar shumë e suksesshme në parandalimin e përkeqësimit të problemeve të ndryshme.

Kur mund të përdoret?

Metoda e ndërmjetësimit familjar mund të përdoret kur familjet vlerësohen se kanë vështirësi për kujdesin e fëmijëve të tyre ose përpiqen të menaxhojnë sjelljen individuale të një fëmije. Një proces i ndërmjetësimit familjar mund të ndërmerret vetëm me pëlqimin e familjeve. Personi që i referohen palët në ndërmjetësimin familjar nuk duhet të jetë lehtësuesi i procesit.

Procesi

Përgatitja dhe angazhimi

1. Lehtësuesi kontakton familjen, duke përfshirë të miturit/të rinjtë e identifikuar si shkaktues të dëmit, për të rënë dakord për çështjet që duhet të zgjidhen dhe për të shpjeguar se si mund të adresojë këto çështje ndërmjetësimi familjar.
2. Lehtësuesi gjithashtu kërkon nga familja të sugjerojë se kush mund të ftohet tjetër, përveç rrethit të ngushtë familjar. Të ftuar mund të jenë anëtarë të familjes më të zgjeruar dhe njerëz të tjerë që luajnë rol në zgjidhjen e çështjes problematike, siç janë miqtë e familjes.
3. Lehtësuesi bisedon me familjen për ndonjë shqetësim ose frikë që anëtarët e saj mund të kenë në lidhje me pjesëmarrjen në takim dhe në lidhje me mbështetjen që ata mund të kenë nevojë. Anëtarët e familjes mund të sjellin një mbështetës ose avokat në takim. Gjithashtu duke biseduar me anëtarët e familjes, vendoset për vendin dhe kohën për zhvillimin e takimit ku do të bëhet ndërmjetësimi familjar.
4. Lehtësuesi duhet të bjerë dakord me personin që referon çështjen se çfarë informacioni duhet t'i jepet familjes dhe çfarë mund dhe nuk mund të dakordësohet si pjesë e planit të veprimit. Lehtësuesi gjithashtu duhet të jetë i vetëdijshëm se cilat shërbime mund të ofrohen për të mbështetur planin e familjes.

Zhvillimi i takimit

- *Dhënia e informacionit:* Lehtësuesi cakton se secili person ka referuar rastin, qartëson qëllimin dhe procesin e ndërmjetësimit familjar dhe se si do të kryhet procesi përmes rregullave bazë. Personi që ka referuar rastin shpjegon arsyen e zhvillimit të këtij takimi dhe ndan informacionin e duhur që ai ka për fëmijën dhe familjen me qëllim për të ndihmuar familjen për të bërë planin dhe për të përshkruar burimet dhe mbështetjen që ata janë në gjendje të ofrojnë. Është e nevojshme të shpjegohet çdo shqetësim i mirëqenies së fëmijës në lidhje me planin (p.sh. se fëmija nuk duhet të ketë kontakt me një person të caktuar). Bëhet gjithashtu e qartë se çfarë veprimi do të ndërmerret nëse familja nuk mund të bëjë një plan ose në rast se familjarët nuk janë dakord me një plan të propozuar. I mituri dhe anëtarët e familjes mund të japin informacion, të kërkojnë sqarime ose të ngrenë pyetje.
- *Koha private e familjes:* Lehtësuesi largohet nga familja duke i lënë të diskutojnë në mënyrë private, duke i bërë të qartë se lehtësuesi është aty pranë kur ata të kenë nevojë për të. Më pas anëtarët e familjes flasin për çështjet dhe dalin me një plan që adreson nevojat e tyre. Anëtarët e familjes identifikojnë burimet dhe mbështetjen që kërkohet nga shërbimet, si dhe nga vetë anëtarët e familjes, për të bërë të mundur realizimin e planit.
- *Plani dhe marrëveshja:* Kur familja ka bërë planin e saj, referuesi i rastit dhe lehtësuesi takohen me familjen për të diskutuar dhe dakordësuar planin duke marrë në konsideratë dhe burimet për realizimin e këtij plani. Plani duhet të miratohet duke patur parasysh që fëmija të mos rrezikohet të dëmtohet. Çdo arsye për mos pranimin e planit duhet të bëhet e qartë menjëherë dhe familjes duhet t'i jepet mundësia për t'iu përgjigjur shqetësimeve dhe për të ndryshuar planin. Është e rëndësishme që të miturit e përfshirë të kenë një kuptim të qartë të asaj që është vendosur dhe se pikëpamjet e tyre dëgjohen e merren parasysh. Shërbimet e specializuara (si psikologu, punonjësi social etj.) duhet të jenë dakord me lehtësuesin (dhe agjencinë që përfaqësojnë), dhe është e rëndësishme që në këtë pikë të specifikohen afatet kohore dhe përgjegjësitë për çdo detyrë. Gjithashtu duhet një dakordësi edhe për planet e emergjencës, monitorimin dhe si të rishikohet plani. Lehtësuesi shpërndan planin tek anëtarët e familjes, referuesi dhe profesionistët e tjerë përkatës.
- *Zbatimi i planit:* Është thelbësore që të gjithë aktorët e përfshirë të jenë përgjegjës për zbatimin e përgjegjësive të tyre në plan brenda afatit të rënë dakord dhe të komunikojnë ose adresojnë ndonjë problem që mund të lindë.
- *Shqyrtimi i planit:* Duhet të ketë një afat kohor të qartë dhe proces për shqyrtimin e zbatimit të planit. Duhet të ofrohet një takim i grupit familjar për shqyrtimin e planit në mënyrë që të gjitha palët të mund të japin llogari për mënyrën se si po zbatohet plani dhe për të bërë ndryshime në të nëse është e nevojshme.

b. Rrethi restaurues

Rrethi restaurues (rrethi i paqes) e ka origjinën nga mënyrat tradicionale të zgjidhjes së konflikteve të praktikuarra ndër fiset indigjene në Kanada dhe SHBA. Ai mbështetet “jo vetëm në konceptin e faljes reciproke, por edhe në përgjegjësinë që ka çdo anëtar i komunitetit për të falur”. Varianti modern i rrethit të paqes është një ndërthurje e ritualeve të drejtësisë tradicionale me procedurat formale të drejtësisë penale.

Kur mund të përdoret?

Rrethet restauruese përdoren me qëllim përmirësimin e kulturës, marrëdhënieve dhe komunikimit mes anëtarëve të një grupi shoqëror për shembull: kur adresohen sjelljet anti-sociale, konfliktet midis të rinjve dhe banorëve më të vjetër në një lagje, dhe konfliktet midis grupeve të tilla si bandat apo grupeve të ndryshme etnike.

Procesi

Përgatitja dhe angazhimi

1. Bazuar në natyrën dhe kontekstin e konfliktit, ftohen ata që janë më të prekur nga dëmi. Këtu përfshihen:
 - ata që perceptohen si autorë dhe viktimë të dëmit dhe ata që kanë marrëdhënie të ngushta me ta;
 - përfaqësuesit e komuniteteve të përfshira në konflikt;
 - përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe institucione që mund të kenë interes në zgjidhjen e konfliktit ose që mund të jenë në gjendje të mbështesin çdo marrëveshje të arritur nga rrethi.
2. Lehtësuesi takohet me çdo pjesëtar të rrethit për të shpjeguar mundësinë e restaurimit të marrëdhënies, duke i ftuar ata të marrin pjesë.
3. Duke takuar secilin person që do të marrë pjesë lehtësuesi merr parasysh:
 - Si do të donin ata që të organizohet rrethi, në ç'rrethana?
 - Çfarë do të duhet për të krijuar këto rrethana?
 - Cilat burime do të nevojiten për të krijuar këto rrethana?
 - Çfarë rregullash dëshirojnë që të ndiqen që të marrin pjesë?
 - Kur dhe ku duhet të realizohet rrethi restaurues?
 - Si mund të përgatitet hapësira për procesin?
 - Si do të lehtësohet procesi?
 - Si do të punojnë bashkëlehtësuesit (nëse ka më shumë se një lehtësues)?

c. Ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës

Rekomandimi i Këshillit të Evropës (1999) në lidhje me Ndërmjetësimin në Çështje Penale e përcakton ndërmjetësimin viktimë-kundërvajtës si “një proces në të cilin viktimia dhe autori i veprës penale mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në zgjidhjen e çështjeve që dalin nga krimi nëpërmjet ndihmës së një pale të paanshme (ndërmjetësi)”. Direktiva e BE-së për ndërmjetësimin në çështjet civile dhe tregtare (2008/52/EC) dhe Rekomandimi i Këshillit të Evropës Rec (99) gjithashtu theksojnë se ndërmjetësimi duhet të jetë në përgjithësi në dispozicion në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale dhe bazuar në pëlqimin e palëve. Ndërmjetësit duhet të jenë të trajnuar në mënyrë profesionale dhe të paanshme. Marrëveshjet e bëra përmes ndërmjetësimit duhet të jenë të arsyeshme dhe të shprehin vullnetin e palëve.

Kur mund të përdoret?

Ndërmjetësimi mund të përdoret me kërkesën e një të mituri/ të riu, i cili pranon përgjegjësinë për një veprim të dëmshëm apo krim ndaj një pale tjetër. Llogaridhënia dhe pritja e dëmshpërblimit bën të mundur që një devijim i tillë nga procedurat ligjore të shoqërohet me besueshmëri publike. Ndërmjetësimi mund të përdoret si një masë parandaluese për të zgjidhur konfliktet aktuale ose të mundshme në mënyrë që të evitohet përshkallëzimi. Procesi i ndërmjetësimit mund të ndryshojë në varësi të situatës, por gjithmonë ai duhet të udhëhiqet nga parimi themelor, sipas së cilit ndërmjetësi që lehtëson dialogun duhet të ndjekë vlerat e praktikave restauruese dhe t'i respektojë palët si përgjegjës të situatës së tyre.

Procesi

- Ndërmjetësi kontakton secilën palë veç e veç për t'i ftuar në ndërmjetësim.
- Ndërmjetësi siguron që palët të jenë të gatshme të marrin pjesë në ndërmjetësim.
- Duke modeluar një qëndrim restaurues, ndërmjetësi ndërton një atmosferë të sigurt për takimin e ndërmjetësimit, krijon besim në procesin e ndërmjetësimit dhe ushqen motivimin për të marrë pjesë.

Nëse palët bien dakord për një proces ndërmjetësimi, ndërmjetësi diskuton se çfarë forme duhet të marrë: drejtpërdrejt (ballë për ballë) ose jo drejtpërdrejt. Në bazë të këtij vendimi, bëhen organizime për procesin e ndërmjetësimit.

Preferohen takimet ballë për ballë. Sidoqoftë, distanca gjeografike, kushtet mjekësore ose faktorë të tjerë mund të kërkojnë një proces jo të drejtpërdrejtë.

Gjatë ndërmjetësimit secila palë lehtësohet për të dhënë variantin e tij ose të saj për incidentin e dëmshëm. Ndërmjetësit shpjegojnë parimet e ndërmjetësimit, të cilat janë:

Neutraliteti, që do të thotë se ndërmjetësit kanë një rol lehtësues por jo rolin e gjyqtarëve, arbitrave apo vlerësuesve.

Konfidencialiteti, që do të thotë se ndërmjetësit si dhe palët e përfshirë në konf-

likt nuk mund të përdorin informacionin e dëgjuar në situatën e ndërmjetësimit ndaj pjesëmarrësve të tjerë, duke premtuar se nuk do të përhapin faktet e dëgjuara në ndërmjetësim për personat jashtë këtij procesi.

Rëndësia e zgjidhjes së konflikteve dhe jo adresimi i fajit.

Vullnetarizmi, që do të thotë se ndërmjetësit sigurojnë që palët të jenë të gatshme të marrin pjesë në procesin e ndërmjetësimit me dëshirën e tyre dhe mund të heqin dorë prej tij në çdo kohë.

1. Palët lehtësohen për të përshkruar dëmin që kanë pësuar.
2. Palët lehtësohen për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre për të rritur mirëkuptimin.
3. Palët lehtësohen për të përshkruar efektet që konflikti ka pasur mbi to.
4. Palët lehtësohen për të treguar se për çfarë kanë nevojë dhe si dëshirojnë që ky dëm të riparohet dhe si të vendoset gjithçka në rregull.
5. Procesi i dialogut lehtësohet derisa palët të jenë të kënaqura dhe të bien dakord për një plan veprimi.
6. Nëse palët nuk mund të arrijnë marrëveshje, rasti do t'i kthehet autoritetit që e ka referuar rastin.
7. Plani i dakordësuar i veprimeve dhe afateve të veçanta paraqitet zyrtarisht me shkrim.
8. Caktohet një kohë për të shqyrtuar zbatimin e marrëveshjes.
9. Vendoset orari për takimin ose procedurën pasuese.
10. Ndërmjetësit ose ofruesit e shërbimit të ndërmjetësimit do të kujdesen për vazhdimësinë:
11. Një sesion tjetër ndërmjetësimi mund të ofrohet kur të jetë e nevojshme.
12. Ndërmjetësit, me dakordësinë e palëve, mund t'i referojnë palët në çdo shërbim mbështetës (p.sh. shërbimet shëndetësore ose të shëndetit mendor ose shërbimet terapeutike ose grupet mbështetëse) nëse kërkohet nga cilado palë.
13. Ndërmjetësit informojnë aktivisht palët për mbajtjen e angazhimeve të tyre. Në rast se marrëveshja nuk mbahet, rasti i kthehet autoritetit për një proces alternativ për të menaxhuar rastin.

ç. Takimet restauruese në grup

Forumi European për Drejtësinë Restauruese ka përcaktuar takimet restauruese në grup si: “takim që zhvillohet pas një kërkesë, për shkak të një sjelljeje kriminale”. Takimi restaurues në grup mund të ndodhë kur kundërvajtësi pranon (ose nuk e mohon) fajin dhe merr përgjegjësinë për krimin.

Takimi realizohet kryesisht ndërmjet shkelësit, viktimës (por kurrë nuk duhet të jetë detyrim për të), mbështetësit e tyre dhe një lehtësues. Pas kësaj, edhe individë të tjerë mund të marrin pjesë, në varësi nga skema apo krimi i kryer, si një përfaqësues i policisë, një punonjës social, një punonjës komuniteti, një avokat etj. Pas një periudhe përgatitore, individët që marrin pjesë në këtë kuvend ulen së bashku dhe diskutojnë krimin dhe pasojat e tij. Ata përpiqen të gjejnë një rezultat të drejtë dhe të pranueshëm për të gjithë, me një marrëveshje që përfshin një numër detyrash për personin

që ka kryer krimin, me qëllim që të riparojë dëmin e kryer ndaj viktimës, komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Kur mund të përdoret?

Në raste serioze kur ekziston një model i vazhdueshëm i shkeljes penale, një i ri ose i mitur mund të ndiqet penalisht nëpër gjykata. Në raste të tilla mund të përdoret takimi restaurues në grup. Kjo metodë jo vetëm lejon përmbushjen e nevojave të viktimave, por gjithashtu lehtëson një dialog më gjithëpërfshirës në lidhje me atë që i mituri/ i riu ka nevojë për të shmangur sjelljet e tjera të dëmshme. Takimet në grup mund të përfshijnë familjen në kuptimin e gjerë, punonjësit socialë dhe ekspertë të tjerë dhe mund të rezultojnë jo vetëm në një plan për dëmshpërblim por edhe në një plan për riintegrimin dhe rehabilitimin. Një plan i tillë mund të jetë pjesë e një sanksioni të komunitetit.

Procesi

- 1. Takimi i parë me të riun/ të miturin përgjegjës për dëmin dhe prindërit / kujdestarët.* Fillimisht lehtësuesi takon personin përgjegjës për dëmin, në rast se ai ose ajo nuk pranon të marrë pjesë në takim. Kjo shmang krijimin e pritshmërive të personit që është dëmtuar.
 - Lehtësuesi shpjegon rolin, qëllimin e takimit dhe jep informacion të detajuar për atë që ndodh gjatë gjithë procesit;
 - Lehtësuesi thekson se takimi restaurues do të përqendrohet në sjelljen dhe dëmin që ka shkaktuar, jo në fajësimin dhe kritikën ndaj të miturit;
 - Lehtësuesi shpjegon rregullat bazë;
 - Lehtësuesi u jep të miturve një mundësi për të treguar historinë e tyre, përmes së cilës i mituri shpreh emocionet, nevojat dhe atë që ai ose ajo dëshiron;
 - Lehtësuesi ndihmon palën të adresojë shqetësimet;
 - Lehtësuesi mundëson që të miturit/ të rinjtë të fillojnë të kuptojnë mendimet dhe ndjenjat e viktimës.
- 2. Takimi i parë me palën e dëmtuar*
 - Lehtësuesi shpjegon rolin, qëllimin dhe procesin e një takimi restaurues.
 - Lehtësuesi shpjegon rregullat bazë.
 - Lehtësuesi i ofron viktimës mundësinë për të treguar historinë e tij/të saj, përmes së cilës ai/ajo shpreh emocionet, nevojat dhe atë që ai/ajo dëshiron.
 - Lehtësuesi fton palën e dëmtuar të marrë në konsideratë atë që mund të dalë nga një takim/ndërmjetësim në grup.
 - Lehtësuesi ndihmon palën të adresojë shqetësimet.
 - Lehtësuesi shpjegon qëllimin e procesit.
 - Lehtësuesi, në bashkëpunim me palën, siguron kohën dhe vendin e takimit restaurues që i përshtatet palës së dëmtuar (viktimës).
 - Nëse viktimë nuk dëshiron të marrë pjesë, lehtësuesi duhet ta bëjë atë të marrë në konsideratë rëndësinë e komunikimit të pikëpamjeve mes tij dhe

kundërvajtësit.

3. Përgatitja e takimeve me secilën palë (veç e veç).

Lehtësuesi përmes takimeve të veçanta pyet secilën palë:

- Çfarë prisni nga takimi restaurues?
- Si do të merrni pjesë në secilën fazë të procesit?
- Çfarë doni të thoni dhe të kërkoni?
- Si do ta thoni?
- Si do t'u përgjigjeni të tjerëve?

Zhvillimi i takimit në grup

Lehtësuesi mundëson realizimin e çështjeve të mëposhtme dhe siguron që palët të ndjekin rrugën e duhur dhe të respektojnë rregullat bazë. Skema nuk mund të jetë e njëjtë për çdo takim në grup, por mund të përshtatet sipas specifikave të çdo rasti.

- Prezantimet dhe rregullat bazë.
- Deklarata e fakteve të pakontestuara.
- Llogaritje për dëmin e shkaktuar nga i mituri.
- Viktima pyet palën e dëmtuar (të miturin, nëse është i tillë).
- Viktima përshkruan dëmin dhe ndikimin e tij.
- I mituri përgjigjet.
- Diskutohet se si të bëhen ndryshimet.
- Diskutohet se si të parandalohen dëmtimet e mëtejshme.
- Dakordësia për planin e veprimit.

Faza pas takimit në grup

Faza pas takimit restaurues në grup mund të bazohet në hapat e mëposhtëm:

- Rishikimi i planit të veprimit dhe dakordësia me hapat për ta përfunduar atë.
- Lehtësuesi ofron mbështetje dhe përforcon angazhimet.
- Lehtësuesi ndërhyr në rast krize për të zgjidhur ndonjë problem që pengon përfundimin e planit.
- Trajtimi i mospërputhjeve në mënyrë restauruese.

d. Rrjetet e mbështetjes dhe përgjegjshmërisë

Kjo është një metodë restauruese që ka origjinën në Kanada dhe shërben si një mjet për mbikëqyrjen dhe mbështetjen e kundërvajtësve për çështje seksuale. Megjithatë, ajo është përshtatur për të miturit dhe të rinjtë të cilët kërkojnë mbështetje intensive për të qëndruar në komunitet ose për lirimin nga paraburgimi. RRMP zakonisht përfshin formimin e një skuadre me të rritur të përgjegjshëm, zakonisht vullnetarë, por mund të përfshijë edhe mbështetje profesionale, familjare etj., pra mbështetje nga individë që janë në kontakt të përditshëm me të rinjtë dhe i mbështesin ata për të mos u përfshirë më në veprimtari të dëmshme, por për t'u përfshirë në jetën në komunitet. I mituri/i riu kundërvajtës merr pjesë në aktivitete pozitive sociale dhe në programe që adresojnë problemet e tij.

Qasja

1. Të rinjtë që kanë kryer sjellje të dëmshme në mënyrë të vazhdueshme përbalen me shumë pengesa për të hequr dorë nga këto sjellje.
2. Nuk është e mundur që një agjenci që vepron e vetme t'u mundësojë të rinjve të heqin dorë nga kundërvajtjet, prandaj bashkëpunimi është thelbësor.
3. Bashkëpunimet janë më efektive kur ndërtohen rreth individit për të përbushur nevojat specifike të tij dhe për të menaxhuar rreziqet specifike. Gjithashtu bashkëpunimi është efektiv kur të gjithë aktorët veprojnë si një ekip i koordinuar dhe bashkëpunues.
4. Bashkëpunimet janë më efektive kur qytetarët si individë kombinohen me ekspertë profesionistë.

Qëllimet

Qëllimi i një rrjeti të mbështetjes dhe përgjegjësisë është:

1. T'u ofrojë ndihmë të miturve/ të rinjve për të pasur një jetë më të mirë.
2. Të forcojë marrëdhëniet e të miturve/të rinjve me familjen, shkollën ose mjedisin ku punon dhe komunitetin (pra të rrisë kapitalin e tyre social).
3. Të mundësojë pjesëmarrjen aktive të shërbimeve të specializuara duke nxitur pjesëmarrësit të punojnë së bashku si ekip.
4. Ta bëjë të miturin/ të riun të ndihet përgjegjës dhe të heqë dorë nga dëmtimi i të tjerëve.

Kur mund të përdoret RRMP?


Në rastin kur i mituri është në rrezik paraburgimi, gjykatat mund të marrin në konsideratë rregullimin për një “rreth të mbështetjes dhe përgjegjësisë”. Kjo qasje mund të përdoret gjithashtu për të mbështetur riintegrimin pas lirim të të miturit nga paraburgimi.

Anëtarësia

Rrethi i mbështetjes dhe përgjegjësisë përbëhet nga dy kategori të anëtarësimit:

1. *Grupi kryesor* përfshin një grup njerëzish nga familja dhe komuniteti i të rinjve, që kujdesen dhe duan ta mbështesin të miturin/të riun kundërvajtës për të arritur qëllimet. Ky grup duhet ta vazhdojë marrëdhënien me të miturin/ të riun shumë kohë pas mbarimit të programit. Në këtë grup mund të përfshihen:
 - familja/kujdestarët;
 - miqtë;
 - fqinjët;
 - mësuesit /punëdhënësi;
 - përfaqësuesi i ndonjë organizate të komunitetit;
 - trajneri sportiv;

- përfaqësues të institucioneve fetare;
 - vullnetarë.
2. Grupi mbështetës i shërbimeve të specializuara, i cili mund të përfshijë, për shembull:
- punonjës të qendrave rehabilituese;
 - psikologë/punonjës të shëndetit mendor;
 - oficerë policie;
 - mentorë;
 - punonjës socialë.



Skema nr. 4. Rrethi tipik

I mituri është në qendër të RRMP-së. I mituri/i riu duhet të besojë se RRMP-ja funksionon për të mbështetur qëllimet e tij dhe se ai duhet të jetë pjesëmarrës aktiv në këtë rreth. Lehtësuesi duhet të udhëzojë të miturin/të riun në mënyrë që ai të mund të marrë një rol kryesor në këtë proces, duke e vënë të miturin në qendër të procesit. RRMP-ja mund të ndryshojë përbërjen e tij me kalimin e kohës. Fillimisht ai mund të nisë me pjesëmarrjen e pak personave, kryesisht profesionistë, por me kalimin e kohës në rreth mund të marrin pjesë dhe mbështetës informalë dhe vullnetarë, anëtarë të komunitetit etj. Kur të shihet e arsyeshme, profesionistët mund të largohen dhe rrethi mund të funksionojë vetë, pa praninë e tyre.

Procesi

Secili anëtar i rrethit takohet individualisht me të miturin në bazë të një planifikimi javor (ose edhe më shpesh) për ta ndihmuar atë të përmbushë qëllimet e tij. Anëtarët e rrethit gjithashtu takohen së bashku si grup në mënyrë të rregullt (zakonisht orga-

nizohen takime mujore), për të shqyrtuar dhe monitoruar progresin e mbështetjes së tyre, për të llogaritur veprimet ndaj njëri-tjetrit, për të zgjidhur problemet dhe për të planifikuar veprime të ardhshme. Kjo shpesh përfundon me një ngjarje apo veprimtari shoqërore.

Roli i lehtësuesit është që të organizojë rrethin dhe të lehtësojë proceset e tij. Lehtësuesi kujdeset për koordinimin dhe administrimin e procesit. Çdo anëtar i rrethit ka detajet e kontaktit për anëtarët e tjerë dhe është i vetëdijshëm se kush po bën çfarë dhe kur. Çdo anëtar i rrethit gjithashtu duhet të mbështetet nga anëtarët e tjerë të rrethit. Lehtësuesi duhet të marrë përgjegjësinë për të siguruar që secili anëtar të ndihet i mbështetur.

VI. SI DUHET TË LEHTËSOHEN PROCESET?

Lehtësuesi është përgjegjës për krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi të sigurt, ku secila palë të mund të komunikojë lirisht dhe të dëgjohej me respekt. Mbi të gjitha duhet të bëhet shmangia e dominimit apo shtrëngimit nëpërmjet ushtrimit të pushtetit. Lehtësuesi duhet të marrë përgjegjësinë për të siguruar që askush nuk përpiqet të dominojë procesin ose rezultatet e tij. Kjo arrihet kryesisht nëpërmjet bërjes së qartë të rregullave bazë dhe zbatimit të tyre. Këto rregulla duhet të bazohen në interesin më të mirë të fëmijës, të drejtën për t'u dëgjuar dhe mbrojtjen nga dëmtimet e mëtejshme. Rregullat zakonisht janë të mbështetura në vlerat e respektit, sigurisë, drejtësisë, të vërtetës dhe konfidencialitetit. Gjatë takimit është përgjegjësia e lehtësuesit të mbajë palët në rrugën e duhur sipas procesit dhe të sigurojë që secili të veprojë në përputhje me rregullat bazë. Parimet (rregullat) bazë mund të përfshijnë:

- *Drejtësia*: procesi do t'i lejojë të gjithëve që të kontribuojnë ashtu siç zgjedhin ata vetë.
- *E vërteta*: njerëzit duhet të flasin të drejtuar sa më shumë të munden nga e vërteta.
- *Respekti*: të gjithë duhet të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe të respektojnë të vërtetën e secilit, edhe kur nuk janë dakord me të.
- *Riparimi i dëmtimit*: fokusi i takimit është riparimi dhe parandalimi i dëmit.
- *Siguria*: askush nuk do të lejohet të fyejë, keqtrajojë ose të frikësojë askënd tjetër.

Tregimet e palëve dhe dialogu i tyre me njëri-tjetrin duhet të nxisin procesin. Lehtësuesi duhet të inkurajojë palët të bisedojnë me njëri-tjetrin dhe jo të bisedojnë përmes lehtësuesit. Proceset më efektive janë zakonisht ato gjatë të cilave lehtësuesi thotë shumë pak. Lehtësuesi duhet të përpiqet të sigurojë që:

- askush nuk është përjashtuar nga pjesëmarrja aktive në proces,
- pikëpamjet e secilit pjesëmarrës të dëgohen me respekt,
- pjesëmarrësit të ndjehen të sigurt dhe të lirë të deklarojnë të vërtetën e tyre,
- nuk ka elementë të shtrëngimit/detyrimit në proces dhe në procedurën e dialogut.

Pyetje të dobishme që lehtësuesi mund të përdorë:

- “Çfarë do të donit të thonit më tepër për këtë?”
- “Çfarë keni kuptuar nga ajo që tha X-i?”

- “Unë e di që është e vështirë për ju të flisni tani. A mund të thoni se çfarë ju pengon të thoni më shumë? »

Nëpërmjet kësaj, lehtësuesi mundëson prezantimin dhe shqyrtimin e të gjitha informacioneve dhe këndvështrimeve përkatëse. Duhet mbajtur parasysh se asnjë dialog nuk është gjithnjë i përsosur në lidhje me përfshirjen, barazinë dhe mungesën e dominimit të pjesëmarrësve, megjithatë duke u përpjekur të mbështetet tek këto vlera, procesi ka të ngjarë të jetë ‘mjaft i mirë’ për pjesëmarrësit.

Përmes ekspozimit ndaj tjetrit, përmes dialogut, kuptohet se marrja e përgjegjësisë nga ana e një personi të vetëm është e pjesshme, e kufizuar dhe jo e plotë dhe kërkon rishikim. Dialogu u mundëson individëve të kuptojnë se nuk ka forca të jashtme, që veprojnë si burim i fuqishëm i së keqes, që i kontrollon ato, por ata janë vetë përgjegjës për veprimet e tyre. Dialogu nxit shfaqjen e ndjeshmërisë dhe dhembshurisë ndërkohë që dobëson ndjenjat e zemërimit, të turp-it apo të frikës.

Ekspozimi ndaj gabueshmërisë dhe dobësisë së tjetrit ballafaqohet me një zgjedhje etike.

Për kundërvajtësit mund të jetë zgjedhja për të kërkuar falje dhe për të bërë ndryshime. Megjithatë për disa palë të dëmtuara (viktima) edhe kur njerëzit kërkojnë falje të sinqerta, kjo është e pamjaftueshme. Ata besojnë se ‘veprimet flasin më shumë se fjalët’. Rrjedhimisht ata shpesh kërkojnë një veprim riparues. Në shumicën e rasteve kjo nuk përfshin dëmshpërblim të drejtpërdrejtë ndaj viktimës, por një lloj shërbimi ndaj komunitetit që ka kuptim për të gjitha palët. Riparimi është i rëndësishëm sepse është një demonstrim i prekshëm dhe i përgjegjshëm i pendimit. Nëpërmjet procesit të riparimit kundërvajtësi pranon se ka vepruar keq dhe merr përgjegjësinë për t’i vënë gjërat në rregull. Në këtë fazë të takimit restaurues në grup viktimat janë të kënaqura që nevojat dhe kërkesat e tyre janë adresuar. Ata nuk janë të fokusuar më tek shqetësimet e shkaktuara nga dëmtimi i kryer dhe nuk besojnë se ka të ngjarë që ky person t’i dëmtojë përsëri.

Për viktimën zgjedhja mund të lidhet me pranimin e mënyrave të ofruara nga kundërvajtësi për të shprehur pendimin dhe për të realizuar dëmshpërblimin, duke hequr dorë nga dënime të mëtejshme. Tani viktimat hyn në një fazë altruiste. Duke pasur parasysh nevojat e të tjerëve, fokusi i viktimës shpesh drejtohet nga siguria e të tjerëve dhe mirëqenia e personit që e ka dëmtuar atë. Viktimat kërkon siguri se kryerësi i dëmit nuk ka ndërmend të dëmtojë të tjerët, një shpjegim për dëmin dhe dëshminë se do të ndërmerren hapa për të ndryshuar çfarëdo që ka shkaktuar sjelljen e dëmshme.

Kështu kundërvajtësi jo vetëm që kryen një veprim riparues, por ai gjithashtu angazhohet të ndërmarrë hapa për të zvogëluar rrezikun e mëtejshëm të dëmit. Viktimat është dikush që është dëmtuar padrejtësisht. Kundërvajtësi ka bërë një zgjedhje duke vepruar në një mënyrë që i ka shkaktuar dëm një personi tjetër, viktimës, pa i lënë asaj mundësi zgjedhjeje, e kjo e fundit nga ana e saj mendon se kundërvajtësi i ka cenuar në një farë shkalle autonominë mbi jetën. Në këtë këndvështrim viktimat duhet të rifitojnë kontrollin mbi jetën e saj.

Plani i veprimit i dakordësuar duhet së pari të adresojë dëmshpërblimin e viktimës. Kjo mund të përfshijë një falje verbale ose me shkrim, kompensimin e humbjes, ose ofertën e punës vullnetare për një bamirësi të propozuar nga viktimat.

Palët mund të bien dakord dhe për çdo mbështetje tjetër që nevojitet për të ri-in-

tegruar personin që ka shkaktuar dëmin. Kjo mund të përfshijë shërbimin e kundërvajtësit në komunitet, në një organizatë lokale, ose mbështetje për t'u kthyer në një shkollë pas pezullimit. Takimi mund të ketë nxjerrë në pah disa nevoja që i vënë të rinjtë në rrezik të shkaktojnë dëme të mëtejshme. Një shembull mund të jetë përdorimi i drogës nga ndonjë kundërvajtës dhe dakordësia mes palëve mund të jetë që i riu të përfshihet në një program rehabilitimi. Në disa raste viktime mund t'i kërkojë kundërvajtësit të bien dakord për një kufizim; për shembull për të qëndruar për një periudhë gjashtë mujore jashtë një dyqani ku ai/ajo ka kryer një vjedhje.

Rezultati i procesit të restaurimit në afat të shkurtër është riparimi i çdo gjëje që është humbur, dëmtuar ose shkelur nga dëmi. Më e rëndësishmja në një proces të suksesshëm, për secilën palë, është që historia e shkaktimit të dëmit të konsiderohet e përfunduar dhe marrëdhënia e restauruar. Duke marrë përgjegjësi, duke shprehur ndjenjën e turpërimit, pendimit, duke marrë përsipër të bëjë riparimin të ndërmarrë hapa për të shmangur dëmtimin e mëtejshëm, i mituri/i riu rikthen respektin e komunitetit ndaj tij dhe mbështetet te komuniteti për t'u riintegruar.

BURIME INFORMUESE

Chapman, T., Gellin, M., Anderson M. *European Reserach on Restorative Juvenile Justice, Vol III*, Belgium, 2015.

Directive 2012/29/EU of the European Parliament and of the Council of 25 October 2012, establishing minimum standards on the rights, support and protection of victims of crime, and replacing Council Framework Decision 2001/220/JHA. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A32012L0029>.

Directive 2008/52/EC of The European Parliament and of the Council of 21 May 2008 on certain aspects of mediation in civil and commercial matters. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008L0052&from=en>

Fellegi, B., Szego, D. *Handbook for Facilitating Peacemaking Circles*, 2013.

Ligj nr.10385, datë 24.04.2018 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Ligj nr.37/2017, datë 30.03.2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”

Ligj nr. 26/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Komentar i ligjit “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”, Nr. 10835, datë 24.02.2011, Botim i Fondacionit “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2012.

Miller, W. R., & Rollnick, S. *Motivational interviewing: Preparing people for change*. New York: Guilford Press, 1991.

Zinsstag, E., & Chapman, T. *Conferencing in Northern Ireland: Implementing Restorative Justice at the Core of the Criminal Justice System*. Oxford: Oxford University Press, 2012.

